

KRITERET PËR VLERËSIMIN E FLETOREVE TË PUNËS

Vlerësimi i fletoreve të punës bëhet në bazë të indikatorëve konkretë për secilin standard veçmas. Për disa standarde është ofruar vetëm një indikator, ndërsa për shumicën hasen dy ose më shumë indikatorë.

Shumica e indikatorëve vlerësohen në një shkallë prej 1 deri në 4. Për këta indikatorë, dy kategori janë të përcaktuara qartë: 4 pikë (gjendja ideale) dhe 2 pikë (gjendje pak më e mirë se ajo krejtësisht e papranueshme). Dy kategoritë e tjera (3 pikë dhe 1 pikë) janë të përcaktuara në mënyrë të tërthortë: kategoria 3 pikë tregon se gjendja e indikatorit është ndërmjet 2 dhe 4 pikëve të definuar, ndërsa kategoria 1 pikë tregon se gjendja është nën minimumin e përcaktuar për 2 pikë.

Ka indikatorë që vlerësohen vetëm nëse plotësohen ose jo. Këta indikatorë nuk i përmbajnë kategoritë 3 pikë dhe 2 pikë, sepse konsiderohet se kategoria 4 pikë përfaqëson gjendjen e vetme të kënaqshme (minimum të domosdoshëm), ndërsa kategoria 1 pikë tregon gjendje të pakënaqshme (nën minimumin e domosdoshëm). Këtu përfshihen të gjithë indikatorët nga fusha e parë *Përputhshmëria me programin mësimor*.

Sipas parimit 1 ose 4 pikë vlerësohen edhe standardet nga fusha e dytë (*Zgjedhja dhe paraqitja e aktiviteteve për nxënësit*) që kanë të bëjnë vetëm me të ashtuquajturat fletore pune relevante, përkatësisht fletore pune që, përmes përmbajtjeve mësimore për të cilat bëhen ose përmes përmbajtjeve të tjera që i përdorin (si informacione shtesë, përshkrime situatash, ilustrime, emra etj.), mund të promovojnë barazi dhe respektim të dallimeve të çdo lloji (standardi 2.5.) dhe/ose të pasqyrojnë përbërjen multietnike të shtetit, të promovojnë respektim të të gjitha komuniteteve etnike në shtet dhe të mbështesin integrimin ndëretnik (standardi 2.6.). Byroja e Zhvillimit të Arsimit përcakton se cila fletore pune (nga cila lëndë/fushë) duhet të konsiderohet relevante dhe cilët standarde e indikatorë duhet të vlerësohen gjatë vlerësimit të asaj fletoreje pune.

Çdo fushë vlerësohet veçmas dhe në mënyrë të pavarur nga të tjerat. Kjo do të thotë që për secilën fushë llogaritet një notë mesatare e veçantë, e cila nxirret nga pikët e dhëna për të gjithë indikatorët e përfshirë në atë fushë. Fletorja e punës propozohet për miratim nëse nota mesatare për çdo fushë është **4.00** (i plotëson të gjitha kërkesat).

Kur vlerësimi i indikatorëve bëhet në shkallë nga 1–4, dhe fletorja e punës për një ose më shumë fusha ka marrë nota mesatare më të ulëta se 4.00 (por jo më të ulëta se 3.00), fletorja e punës **nuk miratohet**, përkatësisht ju kthehet autorëve dhe pritët që autorët të ndërmarrin masa për përmirësim në lidhje me indikatorët që fillimisht janë vlerësuar me notë më të ulët se 4. Pas dorëzimit të përsëritur të fletoreve për miratim, pasi Byroja e Zhvillimit të Arsimit të konfirmojë se nota mesatare për çdo fushë të veçantë ka arritur 4.00 (d.m.th. çdo indikator ka marrë vlerësim 4), fletorja e punës mund të miratohet.

1. PËRPUTHJA ME PROGRAMIN MËSIMOR						
			4 pikë	1 pikë		
1.1.	Fletorja e punës i ndjek temat/fushat/njësitë modulare të parashikuara nga programi mësimor.	1.1.1	Fletorja e punës i përmban të gjitha temat/fushat/njësitë modulare të parashikuara në programin mësimor.	Fletorja e punës nuk i përmban të gjitha temat/fushat/njësitë modulare të parashikuara në programin mësimor.		
		1.1.2	Përqindja e pjesëmarrjes së secilës temë/fushë/njësi modulare në përmbajtjet e përgjithshme të fletores së punës përputhet plotësisht me përqindjen e orëve të parashikuara për realizimin e secilës temë/fushë/njësi modulare, brenda fondit të përgjithshëm të orëve të parashikuara për realizimin e programit mësimor.	Përqindja e pjesëmarrjes së secilës temë/fushë/njësi modulare në përmbajtjet e përgjithshme të fletores së punës nuk përputhet plotësisht me përqindjen e orëve të parashikuara për realizimin e secilës temë/fushë/njësi modulare, brenda fondit të përgjithshëm të orëve të parashikuara për realizimin e programit mësimor.		
1.2.	Fletorja e punës e ndjek programin mësimor në aspektin e përfshirjes së objektivave/rezultateve të parashikuara e të nxënës.	1.2.1	Të gjitha përmbajtjet në fletoren e punës kontribuojnë në arritjen e objektivave/rezultateve e të nxënës të parashikuara në programin mësimor.	Në fletoren e punës ka përmbajtje që nuk mund të lidhen me ndonjë objektiv/rezultat të të nxënës të parashikuar në programin mësimor.		
		1.2.2	Të gjitha aktivitetet e ofruara për nxënës janë në funksion të qëllimeve/rezultateve e të nxënës të parashikuara në programin mësimor.	Fletorja e punës përmban aktivitete për nxënës që nuk janë në funksion të qëllimeve/rezultateve e të nxënës të parashikuara në programin mësimor.		
1.3.	Përmbajtjet e parashikuara në programin mësimor janë përfshirë në fletoren e punës.	1.3.1	Në fletoren e punës janë përpunuar në mënyrë sistematike të gjitha përmbajtjet e parashikuara në programin mësimor.	Në fletoren e punës nuk janë përpunuar të gjitha përmbajtjet e parashikuara në programin mësimor.		
Për fushën 1. PËRPUTHJA ME PROGRAMIN MËSIMOR:						
Fletorja e punës i përmbush plotësisht kërkesat nëse nota mesatare është 4,00.						
Fletorja e punës nuk i përmbush fare kërkesat (dhe nuk duhet të merret parasysh) nëse nota mesatare është më e ulët se 4,00.						
2. PËRZGJEDHJA DHE PASQYRA E AKTIVITETEVE TË NXËNËSVE						
			4 pikë	3 pikë	2 pikë	1 pikë
2.1.	Seksionet në fletoren e punës janë paraparë në një mënyrë që lehtëson kuptimin se çfarë duhet të	2.1.1	Të gjitha aktivitetet janë të organizuara në seksione (njësi më të vogla) dhe çdo seksion ka një titull përkatës.		Aktivitetet janë të organizuara në seksione (njësi më të vogla), por ka seksione (deri në 30%) që nuk janë	

	mësojnë nxënësit, nga aspekti i objektivave/rezultateve të pritura dhe përmbajtjeve mësimore.		Seksionet, të cilave përmbajtjet janë të grupuara në njësi më të vogla, kanë edhe nën-tituj.		titulluar në mënyrë të përshtatshme. Në 50–75% të seksioneve, përmbajtjet e të cilave duhet të ishin grupuar në njësi më të vogla, kjo nuk është bërë ose është bërë një grupim që nuk përputhet me nëntitujt.	
		2.1.2	Të gjitha seksionet i përmbajnë elementet vijuese: tekstin kryesor, detyrat, ushtrimet, ilustrimet dhe hapësirën për shkrimin e përgjigjeve.		Vetëm 75% e seksioneve i përmbajnë të gjitha elementet: tekstin kryesor, detyrat, ushtrimet, ilustrimet dhe hapësirën për shkrimin e përgjigjeve.	
2.2.	Në fletoren e punës janë prezantuar njohuri të sakta, bashkëkohore, të bazuara shkencërisht dhe të rëndësishme/relevante.	2.2.1	Të gjitha aktivitetet bazohen në njohuri bashkëkohore, shkencërisht të bazuara dhe relevante. Të gjitha aktivitetet që janë marrë nga burime të tjera janë të shënuara në mënyrë të duhur dhe burimet janë të cituara ¹ .		Rreth 10% e aktiviteteve nuk bazohen në njohuri bashkëkohore, shkencërisht të bazuara dhe relevante. Rreth 20% e aktiviteteve që janë marrë nga burime të tjera nuk janë të shënuara në mënyrë të duhur dhe/ose burimet e tyre nuk janë të cituara.	

¹ Indikatori *Të gjitha aktivitetet që janë marrë nga burime të tjera, janë shënuar në mënyrë të përshtatshme dhe burimet janë të theksuara*, kjo vlen vetëm për tekstet mësimore ku theksimi i bazës shkencore dhe relevancës së njohurive bëhet përmes identifikimit të burimeve të tjera. Përshtatshmëria e shënimit vlerësohet në bazë të moshës për të cilën është parashikuar fletorja e punës.”

		2.2.2	Të gjitha përkufizimet dhe të dhënat janë të sakta.		Në të dhënat e prezantuara mund të hasen gabime të rralla, por jo thelbësore. Në 5–10% të përkufizimeve vërehen gabime (ose janë të paplota, ose vetëm pjesërisht të sakta).	
2.3.	Detyrat, ushtrimet dhe ilustrimet në fletoren e punës janë në funksion të përmbajtjeve mësimore dhe janë të përshtatura për nxënësit.	2.3.1	Të gjitha detyrat, ushtrimet dhe ilustrimet e përfshira janë të lidhura qartë me tekstin bazë në seksion.		10–20% e detyrave, ushtrimeve dhe/ose ilustrimeve të përfshira janë të panevojshme sepse nuk lidhen qartë me tekstin bazë.	
		2.3.2	Në të gjitha seksionet, raporti midis tekstit dhe ilustrimeve i përshtatet moshës së nxënësve.		Në 10–20% të seksioneve, raporti midis tekstit dhe ilustrimeve nuk i përshtatet moshës së nxënësve.	
		2.3.3	Të gjitha detyrat, ushtrimet dhe ilustrimet janë interesante dhe motivuese për nxënësit dhe janë në relacion me përvojat e tyre.		10–20% e detyrave, ushtrimeve dhe ilustrimeve të përfshira nuk janë interesante për nxënësit dhe nuk lidhen me përvojat e tyre.	
2.4.	Niveli i vështirësisë së aktiviteteve në fletoren e punës i përgjigjet kërkesave të programit mësimor dhe nivelit të zhvillimit kognitiv të nxënësve.	2.4.1	Vëllimi dhe kompleksiteti i aktiviteteve përputhen me kërkesat e programit mësimor.		Aktivitetet në 10–20% të seksioneve janë më të gjera dhe/ose më komplekse sesa kërkohet nga programi mësimor.	
		2.4.2	Vëllimi dhe kompleksiteti i aktiviteteve përputhen me nivelin e zhvillimit kognitiv të nxënësve.		Aktivitetet në 10–20% të seksioneve janë tejet të gjera dhe/ose jo të mjaftueshëm të kuptueshme për nxënësit e moshës përkatëse.	

Vetëm për **FLETORËT PËR PUNË RELEVANTE** – fletoret që, sipas BZHA – së, ofrojnë mundësi të përshtatshme përmes përmbajtjeve mësimore përkatëse ose përmes përmbajtjeve të tjera që i përdorin (si për shembull, informacione shtesë, përshkrime situatash, ilustrime, emra etj.) të përfshijnë edhe standardet/indikatorët e mëposhtëm:

			4 pikë	1 pikë
2.5.	Fletorja e punës nuk zhvillon dhe nuk mbështet stereotipe dhe paragjykime, por promovon barazi dhe respekt për diversitetin në të gjitha aspektet.	2.5.1	Fletorja e punës nuk përmban stereotipe për grupe të ndryshme shoqërore dhe nuk nxit paragjykime (bazuar në gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, përkatësinë etnike dhe fetare, ose përkatësinë në grupet e cenueshme ose të marginalizuara) ² .	Në fletoren e punës hasen stereotipe dhe/ose paragjykime (të shprehura qartë ose në mënyrë të nënkuptuar) për përfaqësues të ndonjë grupi të cenueshëm ose të marginalizuar.
		2.5.2	Në fletoren e punës janë përdorur të gjitha mundësitë përmes përmbajtjeve (tekstet dhe/ose ilustrimet) për të paraqitur në mënyrë pozitive persona të moshave të ndryshme, me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara dhe me status social të ndryshëm.	Në fletoren e punës nuk janë shfrytëzuar mjaftueshëm të gjitha mundësitë për të paraqitur në mënyrë pozitive persona të moshave të ndryshme, me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara dhe me status social të ndryshëm.
		2.5.3	Në aktivitetet (teksti kryesor, detyrat, ushtrimet dhe ilustrimet), pjestarët e gjinisë mashkullore dhe femërore janë të përfaqësuar barabartë dhe trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjitha kontekstet (në jetën private, familjare, profesionale dhe shoqërore).	Në 20–30% të aktivitetëve, përfaqësuesit e gjinisë mashkullore dhe femërore nuk janë të përfaqësuar barabartë dhe/ose nuk trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjitha kontekstet.
		2.5.4	Kur paraqiten figura historike dhe/ose autorë që kanë kontribuar në zhvillimin kulturor dhe shkencor, gjithmonë përmenden edhe gratë.	Gjatë paraqitjes së figurave nga historia dhe/ose autorët të cilët kanë kontribuar për zhvillimin kulturor dhe shkencor nuk theksohen gra.
2.6.	Aktivitetet në fletoren e punës pasqyrojnë përbërjen multi-etnike të shtetit, promovojnë respekt për të gjitha komunitetet etnike dhe mbështesin integrimin ndër-etnik.	2.6.1	Në fletoren e punës janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë, përmes përmbajtjeve (tekstet dhe/ose ilustrimet) dhe aktivitetëve, për të paraqitur në mënyrë pozitive komunitetet etnike të ndryshme në vendin/shtetin tonë.	Në fletoren e punës vërehet një qasje etnocentrike – theksohen karakteristikat e një komuniteti etnik ose të komuniteteve etnike më të përfaqësuara në vendin/shtetin tonë.

² Nëse fletorja e punës i kushtohet për gjuhë amtare apo për histori, duhet domosdoshmërisht të përmbajë aktivitete për nxënësit që ndihmojnë në identifikimin e stereotipeve/paragjykimeve të pranishme dhe në kuptimin e kontekstit, me qëllim që të pamundësohet promovimi i stereotipeve/paragjykimeve ekzistuese.

		2.6.2	Në fletoren e punës janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë, përmes përmbajtjeve (tekstet dhe/ose ilustrimet) dhe aktiviteteve, për të treguar elementët e përbashkët në historinë dhe jetën bashkëkohore, si dhe ngjashmëritë midis kulturave të komuniteteve të ndryshme etnike në shtet.	Në fletoren e punës mbizotëron paraqitja paralele e historisë dhe jetës bashkëkohore të komuniteteve etnike dhe/ose theksohen kryesisht dallimet midis kulturave të komuniteteve etnike.
--	--	-------	--	--

Për fushën **2. ZGJEDHJA DHE PARAQITJA E AKTIVITETEVE PËR NXËNËSIT:**

- Për fletoren e punës relevante: Merren dy nota mesatare – njëra nxirret nga vlerësimi i indikatorëve për standardet 2.1.–2.4., dhe tjetra nga vlerësimi i indikatorëve për standardet shtesë relevante (vetëm 2.5., vetëm 2.6., ose të dyja). Fletorja e punës relevante plotësisht i përmbush kërkesat nëse të dyja notat mesatare janë 4,00, dhe pjesërisht i plotëson kërkesat (dhe duhet përmirësuar) ndodh nëse nota e parë mesatare (për 2.1.–2.4.) është së paku 3,00, ndërsa nota e dytë mesatare (për 2.5. dhe 2.6.) është 4,00. Fletorja e punës relevante nuk i përmbush kërkesat nëse nota e parë mesatare është më e ulët se **3,00** dhe/ose nota e dytë mesatare është më e ulët se **4,00**.
- Për fletoren e punës që nuk është në grupin e relevantes merret një notë mesatare nga vlerësimi i indikatorëve për standardet 2.1.–2.4. Fletorja e punës plotësisht i përmbush kërkesat nëse nota mesatare është **4,00**, dhe pjesërisht i përmbush kërkesat (dhe duhet të përmirësohet) në qoftë se nota mesatare është së paku **3,00**.

3. ASPEKTET DIDAKTIKE - METODIKE						
			4 pikë	3 pikë	2 pikë	1 pikë
3.1.	Fletorja e punës është e strukturuar dhe e organizuar në mënyrë që të ofrojë qartësi dhe të lehtësojë përdorimin e saj.	3.1.1	Në përmbledhjen e përmbajtjes së fletores së punës janë të përfshira të gjitha temat dhe seksionet që mbulohen nga fletorja. Nëse në fletore janë përfshirë edhe pjesë të tjera (jashtë temave kryesore), ato gjithashtu janë të përfshira në përmbajtje.		Në përmbledhjen e përmbajtjes së fletores së punës janë të përfshira të gjitha temat dhe leksionet që mbulohen nga fletorja, por mungojnë pjesët e tjera (jashtë temave) që janë përfshirë në fletore.	
		3.1.2	Çdo seksion përmban tituj dhe nëntituj dhe/ose mënyra të tjera për të theksuar pjesët e tij, të cilat së bashku paraqesin strukturën e seksionit.		Në 10–20% të seksioneve mungojnë nëntituj dhe/ose mënyra të tjera për të theksuar pjesët e seksionit.	
2.	Fletorja e punës është shkruar në mënyrë që t’u mundësojë nxënësve të mësojnë vetë nga ajo.	3.2.1	Të gjitha fjalët e panjohura janë shpjeguar qartë.		Në fletoren e punës hasen 10–20% fjalë të panjohura që nuk janë shpjeguar (ose nuk janë shpjeguar në mënyrë të përshtatshme).	
		3.2.2	Të gjitha aktivitetet e ofruara për nxënësit mund të realizohen vetë, në grup dhe/ose me mbështetjen e të tjerëve.		10–20% e aktiviteteve të ofruara nxënësit nuk mund t’i realizojnë sepse nuk ka kushte të përshtatshme për këtë dhe/ose sepse kërkojnë pjesëmarrje të domosdoshme të një të rrituri ose të një fëmije më të madh.	
		3.2.3	Të gjitha aktivitetet e ofruara për nxënësit janë të lidhura logjikisht me përmbajtjet dhe janë të formuluar qartë (udhëzime të qarta).		10–20% e aktiviteteve të ofruara për nxënësit nuk janë të lidhura logjikisht me përmbajtjet dhe/ose nuk janë të formuluar qartë (udhëzimet nuk janë të qarta).	

		3.2.4	Të gjitha seksionet përmbajnë aktivitete që i nxisin nxënësit të lidhin konceptet/informacionet dhe të nxjerrin përfundime në mënyrë të pavarur.		10–20% e seksioneve nuk përmbajnë aktivitete që i nxisin nxënësit të lidhin konceptet/informacionet dhe të nxjerrin përfundime në mënyrë të pavarur.	
		3.2.5	Të gjitha seksionet përmbajnë ilustrime (shembuj tekstualë, figura, grafikë, skema, tabela etj.) që shërbejnë për të lehtësuar të mësuarit dhe/ose kuptimin e përmbajtjes.		10–20% e seksioneve përmbajnë ilustrime që nuk shërbejnë për të lehtësuar të mësuarit dhe/ose kuptimin e përmbajtjes.	
		3.2.6	Të gjitha seksionet përmbajnë pyetje që i ndihmojnë nxënësit të vlerësojnë sa kanë zotëruar/arritur përmbajtjet/qëllimet mësimore. Në pyetje përfshihen gjithashtu udhëzime për gjetjen e përgjigjeve.		Të gjitha seksionet përmbajnë pyetje që i ndihmojnë nxënësit të vlerësojnë sa kanë zotëruar/arritur përmbajtjet/qëllimet mësimore. Në pyetje nuk përfshihen udhëzime për gjetjen e përgjigjeve.	
3.3.	Fletorja e punës i nxit nxënësit me njohuri të ndryshme paraprake të cilat do t'i zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë nga lënda.	3.3.1	Të gjitha seksionet përmbajnë aktivitete për nxënës me nivele të ndryshme të kompleksitetit/vështirësisë (për t'i përmbushur nevojat e nxënësve me njohuri të ndryshme paraprake). Të gjitha seksionet përmbajnë aktivitete që nxisin përdorimin e njohurive ose mendimin kritik dhe/ose kreativ.		Të gjitha seksionet përmbajnë aktivitete për nxënës me nivele të ndryshme kompleksiteti/vështirësie (për t'i përmbushur nevojat e nxënësve me njohuri të ndryshme paraprake). 10–20% e seksioneve nuk përmbajnë aktivitete që nxisin përdorimin e njohurive ose mendimin kritik dhe/ose kreativ.	
		3.3.2	Të paktën 90% e seksioneve përmbajnë aktivitete për nxënës me nivele të ndryshme kompleksiteti/vështirësie, ku të paktën një aktivitet për seksion është nga		10–20% e seksioneve përmbajnë aktivitete për nxënës me nivele të ndryshme kompleksiteti/vështirësie, ku të paktën një aktivitet për seksion është nga struktura ose lloji i ngjashëm	

			struktura ose lloji i ngjashëm me detyrat e përdorura në testimet ndërkombëtare (p.sh., TIMSS ³ , PIRLS ⁴ , PISA ⁵).		me detyrat e përdorura në testimet ndërkombëtare (p.sh., TIMSS, PIRLS, PISA).	
		3.3.3	Të paktën 70% e seksioneve përkatëse përmbajnë ilustrime dhe/ose aktivitete që lidhin përmbajtjen me jetën e përditshme dhe/ose u mundësojnë nxënësve që vetë të bëjnë këtë lidhje.		10–20% e seksioneve përkatëse përmbajnë ilustrime dhe/ose aktivitete që nuk e lidhin përmbajtjen me jetën e përditshme dhe/ose nuk u mundësojnë nxënësve që vetë të bëjnë këtë lidhje.	
Për fushën 3. ASPEKTET DIDAKTIKO-METODIKE: - Fletorja e punës i plotëson plotësisht kërkesat nëse nota mesatare është 4,00. - Fletorja e punës i plotëson pjesërisht kërkesat (dhe duhet të përpunohet) nëse nota mesatare është të paktën 3,00.						

³ TIMSS (Trends in International Mathematics and Science Study) <https://timssandpirls.bc.edu/>

⁴ PIRLS (Progress in International Reading Literacy Study) <https://timssandpirls.bc.edu/>

⁵ PISA (Programme for International Student Assessment) <https://www.oecd.org/en/about/programmes/pisa.html>

4. GJUHA DHE STILI						
			4 pikë	3 pikë	2 pikë	1 pikë
4.1.	Gjuha dhe stili në të cilën është shkruar fletorja e punës e lehtësojnë kuptimin e përmbajtjes.	4.1.1	Në të gjitha seksionet, teksti kryesor është i organizuar rreth një ideje kryesore.		Në 10–20% të seksioneve nuk janë të organizuara rreth një ide kryesore (ose mungon ideja kryesore, ose përfshihen më shumë se një ide kryesore).	
		4.1.2	I gjithë teksti në fletoren e punës është shkruar me të njëjtin stil.		10–20% e seksioneve janë stilistikisht jo të njëjtë me seksionet e tjera të fletores së punës dhe/ose në 10–20% të seksioneve është përdorur një stil jo i njëjtë në tekstin kryesor.	
		4.1.3	Gjatësia dhe struktura e fjalive në të gjithë tekstin e fletores së punës i përshtatet moshës së nxënësve.		Në 10–20% të tekstit hasen fjali që, për nga gjatësia dhe/ose struktura, janë tepër të komplikua për moshën e nxënësve.	
4.2	Fletorja e punës respekton normat gjuhësore dhe drejtshkrimore të gjuhës në të cilën është shkruar.	4.2.1	Fletorja e punës është lekturuar nga lektor i licencuar për gjuhën në të cilën është shkruar.		Fletorja e punës nuk është lekturuar, por nuk përmban gabime të dukshme gjuhësore dhe drejtshkrimore.	

Për fushën 4. **GJUHA DHE STILI:**

- Fletorja e punës i plotëson në mënyrë tërësore kërkesat nëse nota mesatare është **4.00**.
- Fletorja e punës i plotëson pjesërisht kërkesat (dhe duhet të përpunohet) nëse nota mesatare është të paktën **3.00**.

5. DIZAJNI				
	4 pikë	3 pikë	2 pikë	1 pikë

5.1.	Dizajni grafik siguron qartësi të plotë të strukturës dhe përmbajtjes së fletores së punës.	5.1.1	Variacionet në fontet dhe/ose ngjyrat e lehtësojnë kuptimin e strukturës së fletores së punës, nëqoftëse janë të zgjedhura në mënyrë të përshtatshme dhe të aplikuara në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë fletoren.		Variacionet në fontet dhe/ose ngjyrat janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë fletoren, por nuk janë të zgjedhura në mënyrë të përshtatshme.	
5.2.	Dizajni grafik siguron qartësi të plotë të strukturës dhe përmbajtjes së secilit seksion.	5.2.1	Në të gjitha seksionet përdoren në mënyrë të qëndrueshme elementë grafikë të përshtatshëm (p.sh., variacione në fontet dhe/ose ngjyrat, simbole për shënjimin, korniza për tekste) që lehtësojnë kuptimin e strukturës dhe përmbajtjes së seksioneve.		Në të gjitha seksionet përdoren në mënyrë të qëndrueshme elementë grafikë që lehtësojnë kuptimin e strukturës së seksioneve, por ata nuk janë të zgjedhur në mënyrë të përshtatshme.	
		5.2.2	Të gjitha ilustrimet në fletoren e punës janë titulluara veçmas, të ndara vizualisht nga teksti dhe të vendosura në mënyrë logjike brenda seksionit.		10–20% e ilustrimeve në fletoren e punës nuk janë titulluara veçmas, nuk janë të ndara vizualisht nga teksti dhe/ose nuk janë të vendosura në mënyrë logjike brenda seksionit.	
		5.2.3	Në të gjitha seksionet, pyetjet/aktivitetet për nxënësit janë të dizajnuara veçmas grafikisht dhe të vendosura në mënyrë logjike.		Në 10–20% të seksioneve, pyetjet/aktivitetet për nxënësit nuk janë të dizajnuara veçmas grafikisht dhe/ose nuk janë të vendosura në mënyrë logjike.	
5.3	Pamja e jashtme dhe e brendshme e fletores së punës i plotëson standardet estetike	5.3.1	Të gjitha figurat dhe fotografitë kanë rezolucion të qartë.		10–20% e figurave dhe fotografive nuk kanë rezolucion të qartë.	
		5.3.2	Kopertina është tërheqëse dhe ilustron qartë lëndën mësimore për të cilën bëhet fjalë.		Kopertina ilustron qartë lëndën mësimore për të cilën bëhet fjalë, por nuk është aspak tërheqëse.	

Për fushën 5. **DIZAJNI:**

- Fletorja e punës i plotëson plotësisht kërkesat nëse nota mesatare është **4.00**.
- Fletorja e punës i plotëson kërkesat vetëm pjesërisht (dhe duhet të përpunohet më tej) nëse nota mesatare është minimum **3.00**.

Shtojca

Formular për vlerësimin e fletorëve të punës

Formular për vlerësimin e fletoreve të punës

Vlerësimi i fletës së punës _____

për lëndën mësimore _____

për klasën/vitin _____ të arsimit _____

Fusha 1: PËRPUTHSHMËRIA ME PROGRAMET MËSIMORE		
standardi	Indikator	pikët
1.1. Fletorja e punës i ndjek temat/fushat/njësitë modulare të parashikuara në programin mësimor.	1.1.1	
	1.1.2	
1.2. Fletorja e punës e ndjek programin mësimor në aspektin e përfaqësimit të qëllimeve/rezultateve të parashikuara e të nxënës.	1.2.1	
	1.2.2	
1.3. Nocionet e parashikuara në programin mësimor janë të përfshirë në fletoren e punës.	1.3.1	
Fusha 2: ZGJEDHJA DHE PARAQITJA E AKTIVITETEVE PËR NXËNËSIT		
standardi	Indikator	pikët
2.1. Seksionet në fletoren e punës janë të prezantuara në mënyrë që të lehtësohet kuptimi se çfarë duhet të mësojnë nxënës, nga këndvështrimi i qëllimeve/rezultateve të pritura dhe përmbajtjeve mësimore.	2.1.1	
	2.1.2	
2.2. Në fletoren e punës janë prezantuar njohuri të sakta, bashkëkohore, të bazuara shkencërisht dhe të rëndësishme/relevante.	2.2.1	
	2.2.2	
2.3. Detyrat, ushtrimet dhe ilustrimet në fletoren e punës shërbejnë për përmbajtjet mësimore dhe janë të përshtatura për nxënës.	2.3.1	
	2.3.2	
	2.3.3	
2.4. Niveli i vështirësisë së aktiviteteve në fletoren e punës i përshtatet kërkesave të programit mësimor dhe nivelit të zhvillimit njohës të nxënësve.	2.4.1	
	2.4.2	
Nëse fletorja e punës është e rëndësishme/relevante:		
2.5. Fletorja e punës nuk zhvillon dhe nuk mbështet stereotipe dhe paragjykime, por promovon barazi dhe respekt për dallimet në të gjitha aspektet.	2.5.1	
	2.5.2	
	2.5.3	
	2.5.4	

2.6.	Aktivitetet në fletoren e punës pasqyrojnë përbërjen multietnike të shtetit, promovojnë respekt për të gjitha komunitetet etnike në shtet dhe mbështesin integrimin ndëretnik.	2.6.1	
		2.6.2	
Fusha 3: ASPEKTET DIDAKTIKE-METODIKE			
standardi		Indikatori	pikët
3.1.	Fletorja e punës është strukturuar dhe organizuar në mënyrë që të sigurojë qartësi dhe të lehtësojë përdorimin e saj.	3.1.1	
		3.1.2	
3.2.	Fletorja e punës është shkruar në mënyrë që t’u mundësojë nxënësve të mësojnë vetë prej saj.	3.2.1	
		3.2.2	
		3.2.3	
		3.2.4	
		3.2.5	
		3.2.6	
3.3.	Fletorja e punës i nxit nxënësit me njohuri të ndryshme të zgjerojnë dhe të thellojnë njohuritë nga lënda.	3.3.1	
		3.3.2	
		3.3.3	
Fusha 4: GJUHA DHE STILI			
standardi		Indikatori	pikët
4.1.	Gjuha dhe stili në të cilin është shkruar fletorja e punës e lehtësojnë kuptimin e përmbajtjeve.	4.1.1	
		4.1.2	
		4.1.3	
4.2	Fletorja e punës respekton normat gjuhësore dhe drejtshkrimore të gjuhës në të cilën është shkruar.	4.2.1	
Fusha 5: DIZAJNI			
standardi		Indikatori	pikët
5.1.	Formatimi grafik siguron qartësi të plotë të strukturës dhe përmbajtjeve të fletores së punës.	5.1.1	
5.2.	Formatimi grafik siguron qartësi të plotë të strukturës dhe përmbajtjes së secilit seksion.	5.2.1	
		5.2.2	
		5.2.3	
5.3	Pamja e jashtme dhe e brendshme e fletores së punës i plotëson standardet estetike.	5.3.1	
		5.3.2	